



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|------------------------|----------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivety | 22-04-2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Shënia Organ / Jedinita Org / Unit | Nr. Prot. Prat. No. | Shënia Dreg. Approva | Sasia Kolicina Quantity |
| SHKENCË | 2357/2022 | | 1/3 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.296/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.Nr.915/20 të datës 17.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.677/2019 të datës 04.11.2019 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-harmonizim i koeficientit", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.677/2019 e datës 04.11.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me datë 04.11.2019, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5156/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin që ti behët kompensimi i koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive prej datës 23.11.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.11.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa kjo e fundit me datë 21.11.2019 ka dorëzuar vetëm dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Njoftimit me numër protokolli 5866/2019 të datës 18.12.2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën



A.Nr.677/2019 të datës 04.11.2019, për shkak së Këshilli nuk ka anëtarë, duke udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 17.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.915/20, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit tani ankuesi, ka anuluar njoftimin e datës 18.12.2019 të Këshillit dhe ka obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.677/2019 të datës 04.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5156/2019 të datës 04.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi me numër A.nr.915/20 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 17.03.2022; Fletëkthesë e datës 19.12.2019; Njoftim me numër protokollit 5866/2019 i datës 18.12.2019; Fletëkthesë e datës 11.11.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.11.2019; Kërkesë me numër reference 8/2-4337 i datës 30.10.2019; Kërkesë për zbatimin e vendimit përkatës për nivelizimin e koeficientit të pagës i datës 04.10.2019; Vendim për nivelizim të koeficientit të pagës me numër 2-4116 i datës 25.10.2019; Procedimi në sistem të pagave me numër 3457 i datës 23.11.2017; Përgjigje në ankesë e datës 21.11.2019; Akt Emërimi i N.G. i datës 25.10.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 16.12.2013; Pliko me numër R7591216; E-mail nga C.Z. për A.K. i datës 19.04.2022; E-mail nga A.K. për C.Z. i datës 20.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së është e pa bazuar ankesa e ankuesit *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën e punës *Zyrtar për mësim plotësues dhe diasporë*. I njëjti më datë 04.10.2019, ka parashtruar kërkesë më numër reference 4116 tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për nivelizimin e koeficientit të pagës sipas shkresës së Ministrisë së Administratës Publike me numër protokollit 3457 të datës 23.11. 2017 nga koeficienti shtatë (7) në tetë (8). Sekretari i Përgjithshëm më datë 25.10.2019 me Vendimin me numër 2-4116 të datës 25.10.2019, ka aprovuar nivelizimin e koeficientit të pagës së ankuesit nga shtatë (7) në tetë (8). Ankuesi serish më datë 30.10.2019 parashtron kërkesë për zbatimin e plotë të shkresës së Ministrisë së Administratës Publike me numër protokollit 3457 të datës 23.11. 2017 gjegjësisht kërkon kompensimin e koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 23.11.2017. Ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i MASHT në vet kërkesën e ankuesit të datës 30.10.2019 shënon së refuzohet kërkesa në fjalë si e pa bazë.

Ankuesi, brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet e njëjta, që ti njihet kompensimi i diferencës së koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) në mënyrë retroaktive nga data 23.11.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ju referua dispozitave të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil, ndër lidhur me këtë neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës, dhe rrjedhimisht në kuptim të kësaj bazë ligjore dhe duke u bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi sipas Vendimit me numër 2-4116 të datës 25.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT i është aprovuar nivelizimi i*



koeficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8) dhe i njëjti realizon pagën sipas koeficientit të përcaktuar me këtë vendim. Andaj meqenëse, Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë akt tjetër administrativ të organit të punësimit përmes të cilës ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit nga data 23.11.2017 por vetëm prej datës 25.10.2019, pretendimi ankimor i ankuesit që ti njihet e drejta e kompensimit të koeficientit në mënyrë retroaktive prej datës 23.11.2017, është i pa bazuar.

Po ashtu, Kolegji nga provat e lëndës nuk ka arritur të gjej dëshmi së brenda institucionit të njëjtë ka pasur nëpunës civil me pozitë dhe detyra të njëjta të punës që kanë realizuar pagë sipas koeficientit dhe në periudhën për të cilën ankuesi pretendon në ankesë, fakt ky që sipas vlerësimit të Kolegjit do të paraqiste trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të nëpunësve civil me detyra të njëjta dhe që do ishte në kundërshtim të plotë me nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 2. *Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë.*

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 296/2022

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

